



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 157 prot.

Kamëz, më 20. 11. 2024

V E N D I M

Nr. 116 .Datë 20 / 11 2024

MBI

“ NDRYSHIMIN E EMËRTIMIT TË NJË RRUGE NË TERRITORIN E
BASHKISË KAMËZ”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 20.11.2024, pasi mori në shqyrtim kërkesën për ndryshimin e emërtimit të rrugës; “Demir Gashi” në “Zenel Halilaj” me Nr.Prot. 5977 datë 12.07.2024 , në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nënpika 1.7, shkronja “b”, nenit 54, shkronja “ll” dhe nenit 55, pika 2 dhe 6 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; nenit 3, të ligjit nr. 9270, datë 29.07.2004, “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar; Këshilli Bashkiak Kamëz”;

V E N D O S I :

1. Emërtimin “Zenel Halilaj” , rrugës sipas fragmentit të hartës, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Çdo vendim i mëparshëm që bie në kundërshtim me pikën 1, të këtij vendimi, shfuqizohet.
3. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Publike për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hy në fuqi sipas përcaktimit të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar.

KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI

